



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 6, datë 28 .02. 2013

**PËR  
“DHËNIEN E TITULLIT “MIRËNJOHJE E TIRANËS”, ARTISTIT TË  
MIRËNJOHUR TË FOLKLORIT SHQIPTAR HAXHI MAQELLARA”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8/VII, gërma “a” dhe nenit 32, gërma “m” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin “Për dhënie e titullit “Mirënjohje e Tiranës”, artistit të mirënjohur të folklorit shqiptar z. Haxhi Maqellara, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë propozimin për dhënie e titullit “Mirënjohje e Tiranës” artistit të mirënjohur të folklorit shqiptar, z. Haxhi Maqellara me motivacionin:

*“Për kontributin në ruajtjen e vlerave kombëtare, integrimin kulturor të faktorit shqiptar në botë, si dhe për kultivimin e artit dhe muzikës tradicionale të qytetit të Tiranësi”.*

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**Niazi KOSOVRASTI**